



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:167071  
Datë: 25.10.2024  
Numri i dokumentit: 06351243

K.DH.SH.II.nr.1624/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Alfa Trade” shpk, Komuna Skenderaj me nr. Biznesi 70235948, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Qëndrim Rama avokat ne Prishtinë, ndaj debitorit KRM “Uniteti” me nr. Biznesi 70465104, me seli ne rr. “Vëllezërit Dragaj” ne Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1677/23 dt.05.06.2024, me datën 25.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e kreditorit “Alfa Trade” shpk Komuna Skenderaj, me nr. Biznesi 70235948

II. NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1677/23 dt.05.06.202, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

2.1. Aprovohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit KRM “Uniteti” me nr. Biznesi 70465104, me seli ne rr. “Vëllezërit Dragaj” ne Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.162/2019 dt.09.08.2019 dhe anulohet Urdhri përmbarimor P.nr. 162/2019 dt.09.08.2019 i Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj Mitrovicë, sa i përket pagesës së borxhit të kryegjësë të kërkuar me propozimin për përmbarim.

2.2. Refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit KRM “Uniteti” me nr. Biznesi 70465104, me seli ne rr. “Vëllezërit Dragaj” ne Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit p.nr.162/2019 dt.09.08.2019 dhe Mbetet pjesërisht ne fuqi urdhri përmbarimor P.nr.162/2019 dt.09.08.2019 i Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj Mitrovicë, sa i përket kamatës ligjore prej 8%.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1677/23 dt.05.06.2024, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit KRM “Uniteti” me nr. Biznesi 70465104, me seli ne rr. “Vëllezërit Dragaj” ne Mitrovicë, e ka anuluar urdhrin përmbarrimor P.nr.162/20198 dt.09.08.2019, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Ilmi Miftaraj Mitrovicë dhe ka përfunduar ne tërësi procedurën ne këtë çështje përmbarrimore.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarrimore dhe vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ndërsa debitori te detyrohet te paguaj shumen e borxhit prej 231,294.12 euro si dhe te paguaj shpenzimet e procedurës për ankesë dhe përgjigje ne prapësim ne shumen prej 1,310 euro.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është pjesërisht e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a , me nr. Biznesi 70465104, rr. Vëllezërit Dragaj, ne Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit KRM “Uniteti” me nr. Biznesi 70465104, me seli ne rr. “Vëllezërit Dragaj” ne Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave. Përmbarruesi Privat Ilmi Miftaraj, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.162/2019 dt.09.08.2019, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër te borxhit nga faturat, kreditorit t’i paguaj shumën prej 231,294.12 euro , me kamatë prej 8% nga dita e arritshmërisë se kërkesës për pagesë për secilën faturë respektivisht 30 ditë pas datës se faturës e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit.

Kundër urdhrin përmbarrimor, debitori ka paraqitur prapësim, duke pretenduar se propozimi për përmbarrim nuk plotëson kushte nga neni 71 par.1 nenpar.1.6 dhe 1.12 dhe neni 40 te LPP. Borxhi i debitorit është shumë me i vogël se sa ai i kërkuar nga kreditori i cili ka faturuar edhe për derivatet e naftës për persona qe nuk kane qenë asnjëherë punëtor te debitorit dhe se nuk ka pasur autorizim për marrje te naftës. Debitori i referohet edhe pagesave te bëra nga i njëjti përveç shumave te kryera me herët edhe shumave te paguara pas pranimit te lendes përmbarrimore te cilat ulin detyrimin e tij ndaj kreditorit. Propozon qe gjykata ta anuloj pjesërisht urdhrin përmbarrimor.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me arsyetimin se pretendimet e parashtruara ne prapësim nga debitori nuk janë te bazuara dhe se i njëjti ka për qellim vetëm zvarritjen e procedurës përmbartimore. Andaj propozon qe gjykata ta lë ne fuqi urdhrin përmbartimor sepse ne rastin konkret kemi te bëjmë me dokument te besueshëm, propozon qe gjykata ta refuzoj ne tërësi prapësimin e debitorit si te pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit te prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, shkresave ne lëndë dhe sugjerimeve te shkalles e dytë ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.1677/23 dt.05.06.2024, me te cilin ka vendosur decidivisht si ne dispozitiv te këtij aktvendimi. Arsyeton se faturat lëndore përfshijnë periudhën prej 03.12.2018 deri me 25.06.2019 ndërsa ekstraktet me te cilat është lejuar urdhri përmbartimor, kjo gjykatë i vlerëson se nuk përmbushin kushtet e një dokumenti te besueshëm, meqë sipas nenit 29 par.1 te LPP janë te përcaktuara se cilat ekstrakte janë dokument i besueshëm. Gjykata arsyeton se ne ekstraktet ne baze te cilave është lejuar urdhri përmbartimor, e ku figuron borxhi i bartur ne shumën prej 86,483.19 euro, nuk konsiderohen ekstrakte sipas pikës 1.2 te nenit 29 te LPP, andaj për borxhin e bartur nga faturat te cilat datojnë nga viti 2013 deri ne vitin 2018 gjykata nuk e ka lejuar precizimin/zgjerimin e urdhrin përmbartimor meqë e njëjta nuk lejohet sipas LPP. Lidhur me periudhën e kërkuar dhe faturat nga urdhri përmbartimor rezulton se për faturat nga urdhri përmbartimor totali i shumes se kërkuar është prej 84,874.30 euro. Arsyeton se sipas pagesave qe gjenden ne shkresat e lendes rezulton se shuma prej 130,913.77 euro tashme është përmbushur nga debitori e qe vërtetohet nga pagesat e datës 13.08.2019 ne shumen prej 20,000.00 euro, pagesa e datës 17.10.2019 ne shumen prej 20,000.00 euro, pagesa e datës 26.12.2019 ne shumen prej 70,000.00 euro dhe pagesa e datës 08.09.2020 ne shumën prej 20,913.77 euro, nga kjo gjendje gjykata ka vendos si ne dispozitivin te aktvendimit konform edhe nenit 66 par.4 te LPP dhe nenit 12 par.2 te Ligjit nr.05/L-118 për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Nisur nga një gjendje faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles se dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj ne tërësi përfundimin dhe qëndrimin juridik te gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike nuk është vlerësuar dhe vërtetuar mirë e po ashtu edhe e zbatimi i se drejtës materiale, prandaj Gjykata e shkalles se dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kamatës ligjore.

Ne shqyrtim dhe analizim te gjendjes se provave, kjo gjykatë konstaton se kreditori propozimin për përmbartim e ka mbështetur ne dokumente te besueshme gjegjësisht faturat si ne propozimin për përmbartim, përmes se cilave ka kërkuar përmbushjen e detyrimit ndaj debitorit. Sipas raportit te ekspertizës financiare te datës 16.12.2019, rezulton se detyrimi i debitorit ndaj kreditorit është ne shumen prej 86,941.16 euro ndërsa bazuar ne shkresat e lendes përkatësisht Transferet bankare nga Banka Ekonomike, rezulton se debitori ka bere pagesa me datën 13.08.2019 ne shumen prej 20,000.00 euro, pastaj me datën 14.12.2023 ka paguar shumen prej 20,000.00 euro, me datën 26.12.2019 ka paguar shumen prej 70,000.00 euro, me datën 08.09.2020 ka paguar shumen prej 20,913.77 euro e qe ne total kapin shumen prej 130,913.77 euro, pagesa te cilat nuk i konteston kreditori, e kjo bazuar ne deklaratën e dhënë ne seancën dëgjimore te datës

20.05.2024, ku përfaqësuesi i kreditorit deklaroi se *sa i përket pagesave të dorëzuara nga debitori pas mbajtjes së seancës, të gjitha pagesat që kanë kaluar përmes sistemit bankar i pranohet dhe janë valide deri me sot*, gjë që marrë për bazë faktin se shumica e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, sipas raportit të ekspertizës së ekspertit financiar zt. Mujë Ferati ka rezultuar në shumë prej 84,874.30 euro dhe shumica e paguar nga ana e debitorit në llogari të kreditorit dhe atë prej 130,913.77 euro, gjë që del të jetë me e madhe se shumica e detyrimit të përcaktuar me ekspertizë, edhe kjo gjykatë konsideron se borxhi kryesor i debitorit ndaj kreditorit është përmbushur në tërësi, ndërsa debitori mbetet në detyrime ndaj kreditorit *sa i përket kamatës ligjore prej 8% në shumën e detyrimit prej 84,874.30 euro*.

Në lidhje me këtë çështje kjo gjykatë vlerëson nenin 382 par.1 të LMD i cili parasheh që *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”* ndërsa neni 384 par.1 i LMD parasheh që *“Kreditori ka të drejtë në kamatëvonesën pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit”*.

Prandaj, Gjykata e shkalles së dytë nuk e ka pranuar në tërësi si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me gjendjen faktike të vërtetuar nga e njëjta. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale duke e lënë pjesërisht në fuqi urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj Mitrovicë, sa i përket detyrimit të debitorit në pagesën e kamatës ligjore.

Gjykata e shkalles së dytë ka analizuar edhe pretendimet ankimore të kreditorit se eksperti ka bërë lëshime sepse ka llogaritur disa pagesa nga dy herë, mirëpo vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar prova se cilat janë ato pagesa, sa është shumica e këtyre pagesave, sa është shumica e mbetur në detyrim nga debitori, ashtu që për këto pretendime dhe pretendimet tjera ankimore kjo gjykatë sugjeron kreditorin në procedurë tjera siç është ajo kontestimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale të Kosovës për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1624/24, me datë 25.10.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova